

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Jellena Krivokapiq, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në lëndën kontestimore të paditësit A. R. nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson E. Sh., avokat nga ..., kundër të paditurit E. I. nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson F. B., avokat nga ..., me bazë juridike kompenzim dëmi, vlera e kontestit 27.000 €, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 2715/2014 datë 21.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 11.04.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr.2715/2014 datë 21.11.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C nr.382/08 dt.04.06.2014 pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është obliguar i padituri që paditësit ti paguajë shumën prej 24.000€ në emër të pasurimit pa bazë, me kamatë prej 4%, si për mjetet e deponuara në bankë për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 07.11.2008, deri në pagesën definitive, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës prej 1.174€, të gjitha në afat prej 15 ditë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Në paragrafin II të këtij aktgjykimi është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën është kërkuar që paditësit ti paguajë shumën prej 3.000€, në emër të borxhit kryesor.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AC nr. 2715/2014 dt. 21.11.2017 pjesërisht është aprovuar ankesa e të paditurit dhe është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me kamatën, duke e detyruar të paditurin që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data 07.11.2008 e deri në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit jo të drejtë të dispozitave materiale, me propozim që të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Nuk ka patur përgjigje në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të revizionit, në kuptim të nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Revizioni është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se nuk është kontestuese se paditësi dhe i padituri kanë bërë ndërrimin e automjeteve në vitin 2008 në bazë të një kontrate gojore, ashtu që paditësi i ka dhënë të paditurit një automjet tipit Mercedes B dhe 3.000€, para kesh, ndërsa i padituri i ka dhënë paditësit automjetin e tipit BMW 520. Mirëpo, me që automjeti BMW ka qenë i hipotekuar në Spanjë, nuk ka mundur të bëhet regjistrimi i tij në Kosovë, andaj edhe është prishur kjo marrëveshje, por para se të prishej marrëveshja i padituri kishte tjetërsuar veturën Mercedes B, ndërsa paditësi të paditurit i ka kthyer veturën BMW 520. Vlerën e automjeteve në momentin e ndërrimit e ka caktuar eksperti i cili në ekspertizen e tij ka dhënë vlerën e automjeteve, ashtu që vlera e automjetit Mercedes B është përlllogaritur në shumën prej 21.000€, ndërsa automjeti të tipit BMW 520 është përlllogaritur në vlerën prej 28.000€. Poashtu është vërtetuar se me rastin kur paditësi i ka paguar shumën prej 3.000€, dëshmitariti të dëgjuar në këtë çështje A. M., e cila pagesë është bërë me kërkesën e të paditurit i cili i kishte borxh këtij personi.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe mbi bazën e gjendjes faktike ka aplikuar dispozitat e LPK-së dhe të drejtën materiale dhe ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse, si në pjesën hyrëse të vendimit, për shumën prej 24.000€, në emër të pasurimit pa bazë, pra shuma e vlerësuar prej 21.000€, në emër të automjetit dhe 3.000€, para kesh, në emër të marrëveshjes të ndërrimit të automjeteve që paditësi t'ia paguaj personit të quajtur A. M., borxhin që i padituri i kishte pasur këtij personi, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumën prej 1.174€. Gjykata e Apelit, pas vlerësimit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit dhe e ka

vërtetuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj aktgjykimin e shkallës së parë, me përjashtim të kamatës e cila është ndryshuar.

Gjykata Supreme vëren se në rastin e miratimit të pjesërishtë të kërkesëpadisë së paditësit Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit drejtë kanë aplikuar dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), dhe nuk ka pasur aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Neni 182.2 (n) LPK parashikon se shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo nëse në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit. Pra, aktgjykimi nuk ka të meta për shkak të cilave nuk ka mundur të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe nuk ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit.

Gjykata Supreme më tej vëren se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe mbi bazën e gjendjes faktike kanë aplikuar dispozitat e nenit 210 të LMD-së (Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr.29/78,39/85 dhe 45/89) me të cilin është përcaktuar se 1. Kur ndonjë pjesë e pasurisë së një personi në cilëndo mënyrë ka kaluar në posedim të ndonjë person tjetër, kurse ky kalim nuk bazohet në ligj apo ndonjë punë tjetër juridike, fituesi ka për detyrë ta kthej, në qoftë se kjo është e mundur, por edhe ashtu e ka për detyrë ta kompensoj vlerën e përfitimit të krijuar. 2. Detyrimi i kthimit, respektivisht i kompensimit të vlerës, fillon edhe kur diçka merret duke marrë parasysh bazën që nuk është realizuar ose që është hequr më vonë. Neni 214 i këtij Ligji përcakton se ‘kur kthehet ajo që është fituar pa bazë, duhet kthehen frutet dhe të paguhet kamatëvonesa, e pikërisht, në qoftë se fituesi është i pandërgjegjshëm, që nga dita e fitimit, e për ndryshe që nga dita e paraqitjes së kërkeses’. Në rastin konkret, i padituri është pasuruar pa bazë në shumat e theksuara, pasi me rastin e marrjes së automjetit i padituri nga paditësi ka përfituar pa bazë shumën e vlerës së automjetit dhe shumën kur paditësi i ka paguar në emër të borxhit të

cilin i padituri i ka pasur personit të tretë. Meqenëse, fituesi nuk mund ta kthej automjetin e njëjtë, e ka për detyrë ta kompensoj vlerën e përfitimit të krijuar e cila është caktuar nga ana e ekspertizës gjatë procedurës gjyqësore e cila është bërë në formë të shkruar dhe në mënyrë profesionale, të cilën ekspertizë Gjykata e ka vlerësuar si të saktë dhe si të tillë e kanë pranuar pa vërejtje edhe palët ndërgjyqëse. Gjykata Supreme në tërësi pranon arsyet juridike të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore. Pretendimet për vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kjo Gjykatë e konsideron si të parandësishme, pasi që në këtë drejtim, e konformo nenit 214.2, revizioni nuk lejohet.

Përveç kësaj, Gjykata e Apelit drejtë ka vlerësuar kur ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me kamatën duke iu referuar nenit 227 të LMD-së (Gazeta Zyrtare e ish RSFJ-së nr.29/78,39/85 dhe 45/89), ashtu që është detyruar i padituri që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë datë 07.11.2008, deri në pagesën definitive. Për këtë arsye, është i pabazuar pretendimi lidhur me aplikimin e gabuar të këtij neni.

Për arsyet e paraqitura më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.6/2018 datë 11.04.2018.

Kryetare e kolegjit,
Jellena Krivokapiq

Përktheu: Ferid Abazi